

DEKLARATË E GRUPIT TË KONTAKTIT PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS (31/01/06)

Ministrat e Grupit të Kontaktit, së bashku me Përfaqësuesin e lartë të UE-së, Kryesinë e UE-së, Komisionerin evropian për zgjerim, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s dhe përfaqësuesit e KB-së, duke përfshirë edhe të Dërguarin e Posaçëm të KB-së për statusin dhe PSSP-në, u takuan më 31 janar në Londër. Ministrat shprehën keqardhjen e tyre të thellë për humbjen e Kryetarit Ibrahim Rugova, i cili kishte fituar respektin e botës me parimin e tij për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Ministrat potencuan rëndësinë që duhet t'i kushtojnë një zgjidhjeje të qëndrueshme të statusit të Kosovës që do të promovonte një shoqëri shumetnike. Kjo përfundimisht do të shtonte stabilitetin regional si dhe perspektivën evropiane dhe euro-atlantike të Sërbisë, Kosovës dhe të regjionit në tërësi. Ministrat përkujtojnë faktin se gjatë zgjidhjes së statusit të Kosovës, plotësisht duhet të merret parasysh karakteri i problemit të Kosovës, i krijuar me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe konflikteve pasuese, me spastrimin etnik dhe ngjarjeve të vitit 1999, dhe periudhës së zgjatur të administrat[ës] ndërkombëtare sipas RKSKB 1244. RKSKB 1244 vazhdon të jetë korniza për procesin e statusit që po vazhdon, me Këshillin e Sigurimit dhe Grupin e Kontaktit të cilët vazhdojnë të luajnë rol kyç.

Ministrat besojnë se duhet bërë të gjitha përpjekjet për të arritur një zgjidhje të negociueshme gjatë vitit 2006. Për këtë qëllim, ministrat fuqishëm e mbështesin punën e të Dërguarit të Posaçëm të KB-së Martti Ahtisaarit. Ata i bëjnë thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të punojnë në mënyrë konstruktive në gjetjen e zgjidhjeve realiste për çështjet e shumta të vështira të cilat duhet trajtuar. Këto duhet të përfshijnë, në mes tjerash, lirinë e lëvizjes, lidhjet transparente dhe konstruktive ndërmjet komuniteteve lokale në Serbi dhe Kosovë, mekanizmat për zbulimin e fatit të personave të pagjetur dhe një sërë masash specifike për mbrojtjen e bashkësive dhe monumenteve fetare. Pjesë e kësaj zgjidhjeje duhet të jenë edhe marrëdhëniet e mira në mes të Beogradit dhe Prishtinës në kuadër të regjionit.

Ministrat potencojnë se masat efektive për decentralizimin e qeverisë do të jenë kryesore për zgjidhjen e statusit. Decentralizimi mund të sigurojë që bashkësitë e pakicave të jenë pjesa thelbësore e së ardhmes së Kosovës dhe të nxisë kthimin e personave të zhvendosur, të cilët duhet të kenë mundësi të zgjedhin ku do të jetojnë në Kosovë. Ministrat u bëjnë thirrje palëve që seriozisht të angazhohen në këtë çështje.

Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, së bashku me të gjitha bashkësitë në Kosovë, duhet të bëjnë shumë më tepër për të siguruar implementimin e standardeve të miratuara nga Këshilli i Sigurimit i KB-së. Angazhimi i tyre është kryesor për vendosjen e një statusi të qëndrueshëm në të ardhmen, që të gjithë bashkësive do t'ju mundësonte të jetojnë të sigurt dhe të përparojnë. Ministrat u bëjnë thirrje serbëve të Kosovës dhe bashkësive të tjera pakicë që të shfrytëzojnë rastin e procesit të statusit për të siguruar trajtimin e plotë të problemeve të tyre.

Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit në nëntor 2005 e bëjnë të qartë se nuk do të ketë kthim të Kosovës në gjendjen para 1999, nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe nuk do të ketë bashkim të Kosovës me asnjë pjesë të ndonjë shteti tjetër. Ministrat ritheksojnë gatishmërinë e bashkësisë ndërkombëtare për krijimin e strukturave adekuate ndërkombëtare civile dhe ushtarake, për një periudhë të përkohshme pas zgjidhjes së statusit, për të ndihmuar sigurimin e pajtueshmërisë me dispozitat e marrëveshjes. Qeverisja e përditshme, që duhet të drejtohet në baza shumetnike, duhet të jetë përgjegjësi e përfaqësuesve të zgjedhur sipas rregullit. Ministrat përkujtojnë zotimin e vazhdueshëm të NATO-s për ruajtjen e një ambienti të sigurt dhe të mbrojtur përmes KFOR-it.

Ministrat i drejtohen Beogradit që të ketë parasysh se zgjidhja duhet, në mes tjerash, të jetë e pranueshme për popullin e Kosovës. Politikat shkatërruese të së kaluarës janë shkaktare të problemeve aktuale. Sot, udhëheqësit e Beogradit bartin përgjegjësi të rëndësishme në formësimin e ngjarjeve aktuale dhe atyre në të ardhmen. Grupi i Kontaktit, UE-ja dhe NATO-ja janë të gatshme të mbështesin forcat demokratike serbe që do ta shfrytëzojnë këtë mundësi për t'a çuar Serbinë përpara. Ministrat e përshëndesin arrestimin e Jovo Djogo, por përsërisin se udhëheqësia duhet të përmbushë kërkesat e përsëritura për bashkëpunim të plotë me Tribunalin e Hagës (ICTY), veçanërisht lidhur me Mlladiçin dhe Karaxhiqin. Ministrat, gjithashtu, kërkojnë nga Prishtina që të pranojë se zgjidhja shumetnike është opcioni i vetëm i mundshëm dhe se, sa më shumë që të trajtohen interesat esenciale të pakicave, aq më shpejt do të arrihet një marrëveshje e pranuar përgjithësisht. Ministrat i paralajmërojnë ata që kërkojnë përdorimin e forcës se do t'a minojnë çështjen e tyre.

Së fundi, ministrat vënë në spikamë se një zgjidhje e negociueshme është mënyra më e mirë për të ecur përpara. Do të ndihmonte në krijimin e rrethanave, në të cilat mund të arrihej marrëveshje në dobi të të gjithëve. Angazhimi konstruktiv i palëve gjithashtu do të trasonte rrugën kah e ardhmja evropiane dhe euro-atlantike. Ministrat kërkojnë nga udhëheqësit e Serbisë dhe të Kosovës që të tregojnë guxim politik dhe vizionin e nevojshëm me propozime realiste dhe largpamëse për të ardhmen e Kosovës dhe të Serbisë. Ata kanë kërkuar që i Dërguari për statusin dhe PSSP-ja t'i informojnë për përparimin, dhe premtojnë që t'i kthehen çështjes me kërkesën e tyre apo nëse e kërkon nevoja.